



VENDIM I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 10 prill 2013

Nr. i lëndës: 2012-16

Kristian Kahrs

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 dhe 10 prill 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtar ligjor
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e cila së fundi ka pësuar ndryshime më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa i është parashtruar Panelit përmes postës elektronike më 17 tetor 2012. Më 20 tetor 2012, ankuesi ka dërguar një letër përmes postës elektronike autoriteteve të caktuara të Kosovës, duku e dërguar këtë letër si kopje edhe Panelit, ku ofrohen dokumente të tjera.
2. Më 16 janar 2013, Paneli ka vendosur të njoftoj shefin e misionit të EULEX-it (ShM) rreth ankesës, duke e ftuar atë të parashtrroj vërejtje me shkrim rreth ankesës. Këto vërejtje nga ShM janë pranuar më 1 mars 2013. Më pas ato janë dërguar tek ankuesi për komentim. Më 10

mars 2013, ankuesi ka parashtruar vërejtje të tjera shtesë, të cilat i ishin dërguar ShM për njoftim. Nuk ishin kërkuar vërejtje të tjera.

II. FAKTET

3. Ankesa është paraqitur si një "ankesë zyrtare në lidhje me Policinë e Kosovës (KP) dhe Gjykatën Komunale të Prishtinës". Ankuesi punon si gazetar, me banim në Beograd. Pretendohet se më 3 gusht 2012 në orën 10:00 ankuesi shkoi në Stacionin Policor # 3 në Prishtinë në mënyrë që të takohet me një zyrtar serb të PK-së, pasi ai dëshironte për të diskutuar rreth kërcënimeve që gjoja ishin bërë kundër tij dhe zyrtarit serb të PK-së pasi ai kishte botuar një artikull në lidhje me incidentet në festimin e Vidovdanit në Gazimestan më 28 qershor 2012.
4. Është pohuar se ankuesi ishte arrestuar në Stacionin Policor # 3. Ankuesi pohon se ai u akuzua në bazë të nenit 171 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ("Fotografim i paautorizuar dhe Regjistrime të tjera"). Ankuesi thekson se ai tashmë ishte dënuar dhe gjobitur me 500 euro më 29 qershor 2012 për fotografime gjatë festimit të Vidovdanit dhe se ai ishte akuzua për këtë arsye "për të njëjtën gjë dy herë."
5. Pasi ai nuk ishte në gjendje të kontaktoj avokatin e tij, PK-ja i ka ofruar atij një avokat ndihmës ligjor që fliste serbisht. Ankuesi pohon se ndihma e dhënë nga ky avokat ishte krejtësisht e pakënaqshme e madje ai nuk ishte informuar as edhe rreth emrit të atij avokati.
6. Është pohuar se në orën 14:30, zyrtarët e PK-së nga Divizioni i Krimin Kibernetik kanë marrë në pyetje ankuesin dhe më pas e kanë konfiskuar kompjuterin e tij, dy telefona celular dhe një aparat fotografik. Ankuesi pohon se konfiskimi i pasurisë së tij është kryer pa urdhër gjyqësor dhe prandaj ishte i paligjshme. Gjërat e konfiskuara më në fund u janë kthyer atij në ambasadën norvegjeze më 16 tetor të vitit 2012.
7. Më tej ankuesi thekson se derisa ishte në Stacionin Policor # 3, ai kishte hasur në "një zyrtar suedez dhe zyrtar grek të EULEX-it". Pretendohet se një nga zyrtarët e EULEX-it "i kishte përkujtuar PK-së që ta konfiskonin kompjuterin [tim]", dhe për këtë arsye ka shkelur të drejtat e ankuesit duke "nxitur" konfiskimin e pronave të tij.
8. Është pohuar se PK-ja e ka prangosur ankuesit dhe e ka dërguar në qendrën e paraburgimit në Komisaratin e Policisë # 1. Ankuesi thekson se ai nuk ka pasur qasje në dokumentet që kanë saktësuar akuzat kundër tij. Është pohuar se atij i ishte ofruar një avokat tjetër ndihmës ligjor. Avokati i tij i ri supozohet se nuk i ka ofruar këshilla të duhura rreth mbrojtjes së ankuesit.
9. Ankuesi pohon se ka kaluar mbi 48 orë në paraburgim dhe u soll para gjyqtarit në Gjykatën Komunale të Prishtinës i prangosur në orën 10:25,

të dielën më 5 gusht 2012. Është pohuar se ai nuk ka pasur asnjë mundësi për të mbrojtur veten dhe se ai paraprakisht nuk ka pasur qasje në një avokat mbrojtës. Ankuesi pohon se gjyqtari i ka thënë atij se ai e kishte "shkelur nenin 171", porse nuk e ka marrë ndonjë dokument të shkruar në gjuhën që ai e kuptonte.

10. Është pohuar se avokati për ndihmë juridike i ankuesit ka mbërritur me vonesë në seancën gjyqësore dhe që të dytë, edhe avokati i tij dhe gjykatësi kanë urdhëruar që ai të hesht dhe nuk e kanë lejuar atë "të kundërshtoj ndonjë gjë, sepse gjithçka [kishte qenë e] vendosur paraprakisht".
11. Më tej është pohuar se ankuesi ishte detyruar të nënshkruajë rrëfimin e tij në gjuhën shqipe, pasi ai përndryshe do të dërgohej në një qendër paraburgimi për dy deri tre ditë në pritje të përkthimit të rrëfimit. Pas nënshkrimit të dokumentit, ankuesi ka dashur të kontaktoj ambasadën e tij në Kosovë apo EULEX-in në Kosovë, mirëpo ai ishte dërguar nga PK-ja në pikën e kalimit kufitar në Merdare dhe atje ishte liruar.

III. ANKESAT

12. Ankuesi kërkon një shpjegim se pse EULEX-i ka dështuar të ndërmarrë hapa për të mbrojtur pronën e tij gjatë atij incidenti. Në këtë drejtim, ankuesi përmend nenin 12 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 17 të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Ai ankohet se ishte privuar në mënyrë të paligjshme nga prona e tij.
13. Më tej, ankuesi pohon se ai ishte arrestuar dhe dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale, se ai ishte detyruar të nënshkruajë një rrëfim dhe se të drejtat e tij themelore për gjykim të drejtë ju ishin mohuar, posaçërisht e drejta e tij që t'i ofrohej informacioni në një gjuhë që ai e kuptonte, për natyrën dhe shkakun e akuzave të ngritura kundër tij, që të ketë kohë adekuate dhe lehtësira për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe të drejtën e tij për një përfaqësim efektiv ligjor.

IV. LIGJI

Parashtresat nga palët

14. Në parashtresat e tij, EULEX-i ka deklaruar se ankesa nuk hyn në kuadër të ushtrimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it dhe prandaj duhet të shpallet e papranueshme. EULEX-i ka argumentuar se ankuesi ishte paraburgosur dhe i ishte konfiskuar prona e tij nga PK-ja në pajtim me një urdhër të prokurorit publik në lidhje me një hetim në vazhdim e sipër ndaj kërcënimeve përmes facebook-ut kundër një zyrtari të PK-së.
15. EULEX-i ka pranuar se policët e EULEX-it kanë qenë të pranishëm në kohën përkatëse në stacionin policor në fjalë. Megjithatë nga EULEX-i

është pohuar se ata kanë qenë të pranishëm atje në cilësinë e ofrimit të përgjegjësive për monitorim, mentorim dhe këshillim (MMK) për ta ndihmuar PK-në. Më tej është deklaruar se policët e EULEX-it të pranishëm në stacionin e policisë në atë kohë nuk kanë qenë pjesë e zinxhirit të komandës ekzekutive. Kompetencat ekzekutive kanë mbetur në PK, e cila ka pasur përgjegjësi për të zbatuar urdhrin e prokurorit në pajtim me nenin 6 të Ligjit mbi Policinë. Në këtë drejtim, është pohuar se EULEX-i nuk kishte ushtruar funksione ekzekutive në lidhje me operacionet e prokurorit publik të Kosovës, i cili kishte lëshuar urdhrin lidhur me rastin bazuar në përgjegjësinë e tij/saj.

16. Për më tepër, EULEX-i ka pohuar se nuk ka pasur nevojë që zyrtarët e policisë së EULEX-it të ndërhyjnë duke ushtruar ndonjë formë të funksioneve ekzekutive të kufizuara, në thelb pasi konfiskimi ishte kryer sipas ligjit të Kosovës - në zbatim të urdhrin të prokurorit, i cili qartësisht nuk kishte qenë i paligjshëm. Më tej ishte e hapur mundësia për ankuesin që të kërkojë korrigjim brenda sistemit ligjor të Kosovës duke u mbështetur në mjetet ligjore në fuqi.
17. Sa i përket përgjegjësive të MMK-së së EULEX-it, edhe nëse kishte pasur arsye për të besuar se veprimet e PK-së të ndërmarra kundër ankuesit ishin të paligjshme, EULEX-i nuk do të kishte mandat për të parandaluar zbatimin e urdhrin të prokurorit nga ana e PK-së, pasi çdo ndërhyrje e tillë do të përbënte zëvendësim të autoritetit të institucioneve të zbatimit të ligjit të Kosovës.
18. Më tej u pohua se një interpretim i arsyeshëm në përputhje me mandatin e Misionit për ndihmë ndaj institucioneve të ligjit të shtetit të Kosovës ishte që mjetet ligjore dhe mekanizmat në dispozicion brenda kuadrit të saj ligjor të lejohen të funksionojnë dhe që të ndërhyhet nga ana e Misionit vetëm nëse ato mjete ligjore dhe mekanizma nuk ishin duke funksionuar mirë apo nëse ka pasur ndonjë dështim në sistemin që do t'i bënte ato joefektive.
19. Më tej, është deklaruar se përjashtimi i vetëm që e liron EULEX-in nga detyrimi i tij për të pritur reagimin e sistemit ligjor të Kosovës përmes shfrytëzimit të mjeteve juridike në dispozicion, do të zbatohet në situata ku mund të pranohet se ishte paraqitur një detyrim pozitiv për të ndërhyrë. Megjithatë, këto raste duhet të jenë të kufizuara në lidhje me aktivitetet e MMK-së së EULEX-it, në situata ku ndërhyrja e menjëhershme do ishte e nevojshme në funksion të rëndësisë të së drejtës në fjalë (d.m.th. të drejtat e mbrojtura nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore), për shkak se një ndërhyrje nga institucionet e Kosovës do të ishte e vonuar dhe në këtë mënyrë jo e aftë për të siguruar një mbrojtje të duhur të së drejtës që rrezikon të shkelet në mënyrë të pandreqshme.
20. EULEX-i ka konkluduar se çështja e rastit në fjalë nuk hyn brenda mandatit të Panelit dhe se për këtë arsye kjo lëndë duhet të shpallet e papranueshme.

21. Në përgjigjen e tij, ankuesi ka përsëritur se PK-ja ja kishte konfiskuar në mënyrë të paligjshme pronën e tij. Ankuesi ka pohuar se udhëzimet mbi policinë nga OSBE-ja rreth ballafaqimit me media të saktësuar në pikën 4 se "policia nuk mund të konfiskojë pajisje ose materiale profesionale nga gazetarët, përpos nëse një vendim apo urdhër nga gjykata e autorizon atë. Materialet të cilat janë për t'u konfiskohen sipas Kodit Penal apo që mund të shërbejë si provë në procedurë penale mund të konfiskohen përkohësisht dhe ju dorëzohen Gjykatës për t'i mbajtur ato të sigurta".
22. Ankuesi ka pohuar se pajisjet e tij ka qenë konfiskuar nga ana e PK-së pa një "urdhër të gjykatës" dhe se kjo lëndë duhet të jetë e pranueshme "për shkak të rolit aktiv të luajtur nga EULEX-i në këtë rast".

Vlerësimi i Panelit

23. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
24. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë policisë dhe të doganave.
25. Rrethanat e këtij rasti lidhen me veprimet e ndërmarra nga zyrtarët policor të EULEX-it që punojnë në kuadër të Departamentit të Misionit për Fuqizim. Në këtë drejtim, është vërejtur se ShM ka pranuar se personeli i EULEX-it kishte qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e incidentit.

Masat korrigjuese

26. Siç është pohuar tashmë nga EULEX-i në [*Bahadur dhe të tjerët kundër EULEX-it*](#), 2011-02, 14 shtator 2011 par. 39, "*Policia e EULEX-it mban një kapacitet korrigjues, e cila është një formë e veçantë e kompetencës ekzekutive. Kompetencat e tilla mund të përdoret në lidhje me ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut dhe të vendimeve operative apo administrative jo të duhura të ndërmarra nga Policia e Kosovës*".
27. Paneli vënë re shpjegimin nga ana e EULEX-it se zyrtarët policor të tij të pranishëm në vendin e ngjarjes të incidentit të supozuar ishin duke vepruar në një cilësi për këshillim dhe ushtrim të përgjegjësive të MMK-së.
28. Paneli më tej vënë re, siç pohohet nga EULEX-i, se aktivitetet e MMK-së mund të bartin detyrim pozitiv për të vepruar atëherë kur është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme për shkak të së drejtës së mbrojtur.

29. Në këtë drejtim Paneli konstaton se është përkatëse qasjen e zhvilluar nga Gjykata, që nënkupton se sipas KEDNj-së në rrethana të caktuara mirë, autoritetet kanë detyrim pozitiv për të ndërmarrë masa parandaluese operative në mënyrë që të mbrojnë individin. Në këtë drejtim, Gjykata ka vërejtur në kontekstin e çështjeve lidhur me të drejtën e jetës se "duke pasur parasysh vështirësitë që hyjnë në detyrat policore ndaj shoqërisë moderne, paparashikueshmërisë së sjelljes njerëzore dhe zgjedhjes operative, të cilat duhet të ishin bërë në aspektin e prioriteteve dhe burimeve, një detyrim i tillë duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk imponon ndonjë barrë të pamundur ose të tepërt mbi autoritetet. Prandaj, jo çdo rrezik i pohuar i jetës mund të sjellë për autoritetet një kërkesë nga Konventa për të ndërmarrë masa operative për të parandaluar konkretizimin e atij rreziku. Një konsideratë tjetër e rëndësishme është nevoja për të siguruar që policia ushtron kompetencat e veta për të kontrolluar dhe parandaluar krimin në një mënyrë që përfill plotësisht procesin e duhur dhe garancitë e tjera legjitime, të cilat vendosin kufizime mbi fushën e veprimit të tyre për të hetuar krimin dhe për të sjellë fajtorët para drejtësisë, duke përfshirë garancitë e përfshira në nenet 5 dhe 8 të Konventës" (shih, midis autoriteteve të tjera, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 28 tetor 1998, par. 115 e tutje).
30. Paneli pranon se duke pasur parasysh mandatin e kufizuar të EULEX-it, ai nuk mund të mbahet përgjegjës për mos garantimin e një mbrojtjeje efektive të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe se barra e pamundur ose e tepër sa i përket aspektit policor nuk mund t'i ngarkohet Misionit. Është vënë në dukje se megjithatë ai është obligim i EULEX-it, sipas Veprimit të Përbashkët të Këshillit për të siguruar që aktivitetet e tij duhet të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (shih nenin 3 (i), Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP). Prandaj, kufizimi i detyrimeve të Misionit që paraqiten në kuadër të MMK-së vetëm në situata të kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe serioze të shkeljeve të neneve 2 dhe 3, jo vetëm se do të ishte në mospërputhje me karakterin e EULEX-it si mision i sundimit të ligjit, por gjithashtu do të cenonte efikasitetin e përgjithshëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Përveç kësaj, është vënë në dukje se i paditur nuk ka ofruar asnjë bazë ligjore për këtë argument, qoftë nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit e qoftë nga Plani Operativ i Misionit apo nga ndonjë autoritet tjetër ligjor.
31. Prandaj, Paneli konkludon se brenda kontekstit të MMK-së, detyrimi i zyrtarëve të EULEX-it për të vepruar në mënyrë që të parandalojnë shkeljet e të drejtave të njeriut mund të thuhet se paraqitet atëherë kur ata ballafaqohen me ndonjë kërcënim të ndonjë shkelje të drejtpërdrejtë apo serioze të të drejtave individuale, pavarësisht se për çfarë të drejte bëhet fjalë. Natyra e reagimit duhet të jetë e përshtatshme për rrethanat dhe, nga ana tjetër, varet se çfarë e drejte dhe çfarë të drejta janë vënë në rrezik dhe rreth seriozitetit të kërcënimeve ndaj këtyre të drejtave.

32. Duke iu referuar rrethanave të rastit konkret, Paneli pohon se zyrtarët e policisë së EULEX-it të pranishëm gjatë incidentit material kanë qenë duke vepruar në cilësinë e MMK-së. Paneli është i mendimit se në rastin konkret rrethanat rreth të cilave ka ankesë nuk kanë qenë të tilla sa për të nxitur detyrimin e zyrtarëve të EULEX-it për të ndërhyrë dhe vepruar në cilësinë e tyre korrigjuese. Është vënë në dukje në këtë lidhje se nuk ka qenë e argumentuar, e lere më treguar, se ankuesi nuk i kishte në dispozicion mjetet e tij ligjore për të adresuar çështjen e konfiskimit gjoja të paligjshëm të pronës së tij. E as nuk është argumentuar se në rrethanat e këtij rasti mjetet në dispozicion, për disa arsye specifike të rastit, nuk do të jenë efektive, Më tej është vënë në dukje se ankuesi nuk ishte nën kërcënim për jetë. E as nuk ju ishte nënshtruar ndonjë kërcënim për integritetin e tij personal. Asnjë kërcënim i përdorimit të forcës fizike nuk ishte bërë ndaj tij. Ai nuk ishte i keqtrajtuar gojarisht. E drejtë e vënë në rrezik ka të bëjë me gëzimin paqësor të pasurisë e tij. Paneli është i ndjeshëm ndaj faktit se materiali i konfiskuar, d.m.th. kamera e tij dhe kompjuteri kanë qenë të përdorura nga ana e ankuesit për qëllime profesionale. Megjithatë, nuk është argumentuar se vlera e tyre monetare ishte shumë e lartë ose që është shkaktuar ndonjë dëm serioz për të cilat ndryshe ai nuk mund të kërkojë dëmshpërblim. Në analizë të fundit, ato më në fund ju janë kthyer atij.
33. Duke parë si tërësi rrethanat e rastit, Paneli është i mendimit se situata për të cilën ka ankesë nuk ka krijuar ndonjë situatë që do të kishte detyruar zyrtarët e policisë së EULEX të ndërhyjnë në autoritetet vendore, në mënyrë që ta ndalonin apo parandalonin shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit.
34. Prandaj e deklaron këtë pjesë të ankesës si të papranueshme.
35. Çështjet e mbetura që janë ngritur nga ankuesi kanë të bëjnë me pretendimet e tij se ai ishte arrestua nga PK-ja dhe ishte dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale të supozuar, se ai ishte i detyruar të nënshkruajë një rrëfim dhe se të drejtat themelore të një gjykimi të drejtë i ishin mohuar. Paneli konstaton se nuk ka treguar apo argumentuar se EULEX-i në Kosovë ka qenë i përfshirë me ndonjë cilësi në ato rrethana të rastit (shih [Mustafa kundër EULEX-it](#), 2011-03, 8 prill 2011, në par. 22).
36. Si rezultat, çështjet në fjalë në këtë pjesë të kësaj ankese nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

gjen se kjo ankesë bie jashtë kompetencave të Panelit sipas kuptimit të nenit 29 (d) të rregullores së vetë të punës, dhe

SHPALL KËTË ANKESË TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
kryesuese